



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.4/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Kujtim Pasuli - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Korab Mushkolaj nga Komuna e Deçanit, kandidat i propozuar nga Partia Demokratike e Kosovës për Kryetar të Komunës së Deçanit, paraqitur kundër Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr.Protokolli 01/2196/2025, të datës 21.08.2025, për shkak të refuzimit për çertifikimin e kandidatit për Kryetar të Komunës së Deçanit, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë: 23.08.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar, ankesa e kandidatit të Partisë Demokratike të Kosovës Korab Mushkolaj nga Komuna e Deçanit, i propozuar për Kryetar të Komunës së Deçanit, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr.Protokolli 01/2196/2025, të datës 21.08.2025, për shkak të refuzimit për çertifikim të kandidatit për Kryetar të Komunës së Deçanit, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 22.08.2025 PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruar nga kandidati i propozuar për Kryetar të Komunës së Deçanit, nga Komuna e Deçanit, me të cilën theksohet se me Akt Emërimin Nr.050, datë 11.01.2013, është emëruar në pozitën Zyrtar i Lartë për Politika Konsullore në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me gradë Koeficienti 8 dhe nivel profesional. Kjo pozitë hyn në kategorinë e shërbimit civil dhe me status të veçantë, sipas Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës. Në vazhdim ka theksuar se më datë 04.08.2025, ka paraqitur kërkesë për pezullimin e marrëdhënies së punës, në përputhje me nenin 25 të Ligjit Nr. 08/L-197, për Zyrtarët Publik. Ky pezullim është bërë me qëllim që të eliminohet çdo konflikt interesi dhe të sigurohet përputhshmëria me ligjislacionin zgjedhor. Vendimi për pezullim është lëshuar nga Ministria dhe ka hyrë në fuqi para datës së afatit të çertifikimit. Parashtruesi i ankesës me tej thekson se me datë 21 gusht 2025, KQZ, me vendimin nr. 01/2196-2025, respektivisht me pikën 3 të dispozitivit të këtij vendimi, ka refuzuar çertifikimin tim duke u thirrur në nenin 30 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, duke konstatuar se unë jam "funksionar publik dhe anëtar i shërbimit të jashtëm". Kjo është pasqyruar në pikën 3 të dispozitivit të vendimit, i cili është objekt i kësaj anekse. Ky vendim është dhënë pa marrë

parasysh faktin e pezullimit ligjor, pa trajtuar provat e dorëzuara dhe pa dhënë arsytim juridik të plotë.

Ka shtuar faktin se dispozitën e nenit 30 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, paragrafin 1 nënparagrafët 1.1 dhe 1.2, duhet lexohet jo si një ndalesë absolute, por si një kufizim i kushtëzuar. Teksti ligjor thotë qartë se përjashtohen nga çertifikimi vetëm ata persona që janë funksionarë publikë me status të veçantë ose anëtarë të shërbimit të jashtëm në momentin e shqyrtimit të kandidaturës, pra gjatë ushtrimit aktiv të funksionit. Nëse funksioni është pezulluar, nuk ka më situatë të jokompatibilitetit. Kjo është e kuptueshme edhe nga natyra e së drejtës për të kandiduar: një e drejtë themelore kushtetuese që mund të kufizohet vetëm për aq sa është e domosdoshme për të ruajtur parime të rëndësishme publike, siç është neutraliteti i administratës dhe shërbimit të jashtëm. Nëse një kandidat, duke qenë i vetëdijshëm për këtë kufizim, ndërmerr veprimin ligjor të pezullimit të marrëdhënies së punës, atëherë arsyeja e kufizimit pushon së ekzistuari. Në këtë rast nuk ekziston më rreziku i ndikimit të pozitës publike në garën zgjedhore dhe nuk ka asnjë shkak ligjor që i ndalon kandidatin të marrë pjesë në zgjedhje.

Ligji për Zyrtarët Publik, në nenin 25, parashikon institutin e pezullimit të marrëdhënies së punës, si një mekanizëm mbrojtës për të garantuar që zyrtarët të mos gjenden në konflikt interesi në rast të kandidimit për një pozitë politike. Ky nen ka karakter të posaçëm, sepse ligjvënësi ka dashur të krijojë pikërisht një zgjidhje praktike për raste të tilla.

Në përputhje me këtë dispozitë, unë kam ushtruar të drejtën time ligjore duke dorëzuar kërkesën për pezullim më 04.08.2025, pra para afatit përfundimtar të çertifikimit të kandidatëve. Kjo kërkesë nuk është një akt formal pa efekt, por është instrument juridik që pezullon ushtrimin e detyrës publike dhe i ndërpret përkohësisht të gjitha atributet që më lidhin me pozitën e funksionarit publik dhe anëtarit të shërbimit të jashtëm. Në momentin kur KQZ ka shqyrtuar dosjen time të kandidaturës, marrëdhënia ime e punës ishte pezulluar dhe unë nuk kisha më asnjë të drejtë, asnjë detyrim dhe asnjë privilegj që burojnë nga funksioni publik. Në këtë mënyrë, nuk mund të konsiderohem funksionar publik aktiv dhe as pjesë e shërbimit të jashtëm në kuptimin e nenit 30 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Refuzimi i kandidaturës ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta për ankuesin, duke më mohuar të drejtën themelore për kandidim, pavarësisht respektimit të ligjit. Gjithashtu, ky vendim ka pasoja për zgjedhësit e Komunës së Deçanit të cilëve u është mohuar mundësia të votojnë kandidatin e propozuar, duke cenuar kështu parimin e pluralizmit politik dhe lirinë e zgjedhjes. Në plan më të gjerë, ky vendim dëmton integritetin e procesit zgjedhor dhe minon besimin publik në KQZ si institucion që duhet të garantojë ligjshmërinë dhe barazinë në garën zgjedhore, theksohet në ankesë.

Parashtruesi ka bashkangjiur ankesës provat si: Vendimi i KQZ-së për moscertifikim, Kërkesën për pezullim (04.08.2025) Akti i Emërimit Nr. 050, datë 11.01.2013.

Në përgjigjen në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sqaron gjithë ecurinë e procesit të zhvilluar nga ana e saj duke theksuar se në përputhje me Planin Operacional të aprovuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 12 Tetor 2025, perioda e aplikimit për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre ka filluar më 26 qershor 2025 dhe përfundoi më 13 gusht 2025.

Ky subjekt politik ka paraqitur kandidaturë për Kuvendin e Komunës në komunën e Deçanit, siç përcaktohet me Rregulloren Zgjedhore Nr. 04/2024 për Certifikimin e Subjekteve Politike dhe të Kandidatëve të tyre, subjekti politik ka përmbushur të gjitha obligimet përmes dorëzimit të dokumentacionit të mëposhtëm: Deklarata politike, kodi i mirësjelljes, lista e kandidatit të subjektit politik, formulari i certifikimit të kandidatit;

Sa i përket verifikimit të kandidatëve Zyra për Regjistrim, Çertifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, pas kompletimit të aplikimit për certifikim nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, ka dërguar listën e kandidatëve për verifikim në institucionet relevante sipas kërkesave të nenit 30 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Pika 1.2, paragrafi 1 i nenit 30 thekson se cilido person emri i të cilit paraqitet në Listën e votuesve është i aftë për certifikim si kandidat përveç nëse ai/ajo, në Republikën e Kosovës osc jashtë saj, është anëtar i shërbimit të jashtëm dhe përfaqësues diplomatik. Nisur nga kjo, në mesin e institucioneve për verifikim të listës së kandidatëve, Zyra ka dërguar listën edhe te Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporë.

Rezultati i verifikimit të pranuar nga MPJD, ishte se Korab Mushkolaj, kandidat për Kryetar Komune në komunën e Deçanit ka rezultuar të jetë i angazhuar me aktemërim të përhershëm në MPJD si Zyrtar i Lartë në Divizionin e Ceremonialit, në Departamentin e Protokollit të Shtetit. Pas kërkesës për sqarim nga Zyra se nëse kjo pozitë llogaritet si anëtar i shërbimit të jashtëm dhe përfaqësues diplomatik, MPJD ka kthyer përgjigje duke konfirmuar se bazuar në Ligjin Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, Neni 2, paragrafi 2.2, "Anëtarët e shërbimit të jashtëm" përfshijnë anëtarët e përhershëm të Ministrisë, si dhe anëtarët e saj të caktuar në misione diplomatike dhe konsullore në shtete të tjera ose në organizata ndërkombëtare.

Nisur nga kjo gjetje, Zyra ka kontaktuar Partinë Demokratike të Kosovës duke e njoftuar me gjetjen dhe duke udhëzuar për zëvendësimin e kandidatit. Përmes njoftimit të dërguar më 21.08.2025, Partia Demokratike e Kosovës ka njoftuar se refuzon të zëvendësojë kandidatin duke theksuar se bazuar në dokumentacionin që posedon PDK, vlerësojnë se kandidati Korab Mushkolaj i plotëson të gjitha kriteret ligjore për të qenë kandidat në Komunën e Deçanit dhe se Z. Mushkolaj nuk është pjesë e shërbimit të jashtëm dhe nuk ushtron funksion si përfaqësues diplomatik. PDK gjithashtu në njoftimin e tyre kanë theksuar se sipas aktemërimit të tij, ai është në pozitën e nëpunësit civil, dhe konsiderojnë se vlerësimi i dhënë nga MPJ-ja nuk është i drejtë, për më tepër, para 17 ditësh, z. Mushkolaj ka dorëzuar kërkesën për pezullimin e pozitës në ministri, në përputhje me Ligjin për Zyrtarët Publikë. Rekomandimi i Zyrës.

Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 30, paragrafi 1, pika 1.2, cilido person emri i të cilit paraqitet në Listën e votuesve është i aftë për certifikim si kandidat përveç nëse ai/ajo, në Republikën e Kosovës ose jashtë saj, është anëtar i shërbimit të jashtëm dhe përfaqësues diplomatik. Pas gjetjes së MPJD se kandidati Korab Mushkolaj hyn në kategorinë e anëtarit të shërbimit të jashtëm dhe pas refuzimit të Partisë Demokratike të Kosovës për zëvendësimin e tij, Zyra ka përgatitur rekomandimin për certifikimin e të gjithë kandidatëve të tjerë të Partisë Demokratike të Kosovës dhe refuzimin e certifikimit për kandidatin Korab Mushkolaj.

Në përgjigje theksohet se me datën 21 Gusht 2025, KQZ ka mbajtur takimin Nr.50 në të cilin është prezantuar rekomandimi i Zyrës për certifikimin e të gjithë kandidatëve të tjerë të Partisë Demokratike të Kosovës dhe refuzimin e certifikimit të kandidati Korab Mushkolaj.

Pas përfundimit të diskutimeve me ç'rast përfaqësuesit e Partisë Demokratike të Kosovës kanë shprehur pakënaqësinë e tyre për një gjetje të tillë nga MPJD, dhe e kanë konsideruar të padrejtë, ata gjithashtu kanë theksuar se votimi i tyre do të jetë për certifikimin e listës së plotë të kandidatëve të Partisë Demokratike të Kosovës së bashku me kandidatin Korab Mushkolaj.

Rekomandimi është hedhur në votim si i plotë, për certifikimin e të gjithë kandidatëve të tjerë dhe refuzimin e certifikimit për kandidatin Korab Mushkolaj dhe ka marrë nëntë (9) vota për dhe dy (2) vota kundër, si rezultat rekomandimi mori votat e nevojshme për të kaluar duke pasur parasysh që sipas paragrafit 4 të nenit 63 të LZP, për tu certifikuar një subjekt politik, duhet të marrë 2/3 e votave.

Rrjedhimisht, të gjithë kandidatët e tjerë të Partisë Demokratike të Kosovës janë certifikuar dhe është refuzuar certifikimi për kandidatin Korab Mushkolaj, siç parashihet në paragrafin 4 të nenit 17 të LZP, dhe është marrë Vendimi 01/2196-2025.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë të KQZ, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës ka përfunduar të gjithë hapat e aplikimit për certifikim përmes platformës elektronike për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, përfshirë edhe listën e kandidateve në Zyrën për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ. Zyra ka përgatitur rekomandimin për certifikimin e të gjithë kandidatëve të tjerë të Partisë Demokratike të Kosovës dhe refuzimin e certifikimit për kandidatin Korab Mushkolaj. Rekomandimi është hedhur në votim si i plotë, për certifikimin e të gjithë kandidatëve të tjerë dhe refuzimin e certifikimit për kandidatin Korab Mushkolaj dhe ka marrë nëntë (9) vota për dhe dy (2) vota kundër, si rezultat rekomandimi mori votat e nevojshme për të kaluar duke pasur parasysh që sipas paragrafit 4 të nenit 63 të LZP, për tu certifikuar një subjekt politik, duhet të marrë 2/3 e votave.

Rrjedhimisht, të gjithë kandidatët e tjerë të Partisë Demokratike e Kosovës janë certifikuar dhe është refuzuar certifikimi për kandidatin Korab Mushkolaj, siç parashihet në paragrafin 4 të nenit 17 të LZP dhe nenit 2 par.2.2 të Ligjit nr.03/L-122 për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës si dhe pika 1.2 par.1 i nenit 30 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, është marrë Vendimi 01/2196-2025.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se kundërshton pikën 3 të dispozitivit të vendimit të KQZ-së, 01/2196-2025, me të cilin ka refuzuar certifikimin e tij, duke u thirrur në nenin 30 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, duke konstatuar se është "funksionar publik dhe anëtar i shërbimit të jashtëm, dhe nuk ka marrë parasysh faktin e pezullimit ligjor pa trajtuar provat e dorëzuara dhe pa dhënë arsyetim të plotë juridik", Paneli vlerëson se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, sepse nuk ka dorëzuar asnjë provë për të mbështetur pretendimin e tij për pezullim, mirëpo pavarësisht këtij fakti sipas neni 30 par.1 nënparagrafi 1.2 i LZP-së, përcaktohet se: *cilido person, emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve, është i aftë për certifikim, si kandidat përveç nëse ai/ajo, në Republikën e Kosovës ose jashtë saj, është: anëtar i shërbimit të jashtëm dhe përfaqësues diplomatik si dhe nenit 6 të Ligjit nr.08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.08/L-197 për zyrtarët publik, i cili parasheh se " nënpunësi civil me status të veçant është nënkategori e nëpunësit civil, ku sipas par.1 pika 1.3 hynë edhe anëtarët e shërbimit të jashtëm".*

Duke u nisur nga fakti se dispozitat e lartëcekura shprehimisht parashohin përshtatshmërinë dhe aftësinë e kandidatit për certifikim si kandidat, atëherë duke marrë parasysh statusin e tij të anëtarit të shërbimit të jashtëm, kandidaturën e tij e bënë të papërshtatshëm për certifikim për arsye se, pozita e tij është konfirmuar edhe nga burimet njerëzore të institucionit të punëdhënësit dhe kjo përcaktohet edhe me Ligjin Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, Neni 2 "Anëtarët e shërbimit të jashtëm" përfshijnë anëtarët e përhershëm të Ministrisë.

Prandaj, pretendim i kandidatit lidhur me pezullimin ligjor, nuk ka ndikim në vendosje ndryshe për faktin se, statusi i punësuarit si anëtar i shërbimit të jashtëm ia pamundëson kandidaturën për kryetar komune për zgjedhjet lokale të Republikës së Kosovës të cilat do të mbahen me datë 12.10.2025. Andaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", pasi që theksimet në ankesë janë vetë deklaratime dhe nuk janë argumentuar me prova konkrete.


Paneli vlerësoj se me vendimin e ankimuar nuk janë cenuar të drejtat e kandidatit për pjesëmarrje në zgjedhje, sepse me dispozitat imperative ligjore është përcaktuar qartë kush mund të certifikohet për kandidat, prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A.nr.4/2025, datë: 23.08.2025

Kryesues i Panelit
Kujtim Pasuli



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.74/2025


GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.Sc.Muhamet Rexha kryetar, Rrustem Thaqi dhe Delushe Halimi, anëtarë, në çështjen juridike të parashtruesit të ankesës Korab Mushkolaj nga Komuna e Deçanit, kandidat i propozuar nga Partia Demokratike e Kosovës për Kryetar të Komunës së Deçanit, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me nr.prot.01/2196/2025 dt.21.08.2025, për shkak të refuzimit për certifikim të kandidatit, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më dt.12 Tetor 2025, tani duke vendosur sipas ankesës së Korab Mushkolaj, paraqitur kundër Vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.4/2025 dt.23.08.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më 27.08.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa themeltë ankesa e kandidatit të Partisë Demokratike të Kosovës Korab Mushkolaj nga Komuna e Deçanit, paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.4/2025 dt. 23.08.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.4/2025 të dt.23.08.2025, është refuzuar e pa bazuar ankesa e kandidatit të Partisë Demokratike të Kosovës Korab Mushkolaj nga Komuna e Deçanit, i propozuar për Kryetar të Komunës së Deçanit,



paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr.prot.01/2196/2025 të dt.21.08.2025, për shkak të refuzimit për certifikim të kandidatit për Kryetar të Komunës së Deçanit, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen më datën 12 Tetor 2025.

Kundër vendimit të sipërpërmendur të PZAP-së, Korab Mushkolaj, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, me të cilën konteston ligjshmërinë e vendimit të PZAP-it, përkatësisht për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit material, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet vendimi A.nr.4/2025 dt.23.08.2025 si dhe vendimi i KQZ – së, nr.01/2196/2025 dt.21.08.2025 dhe të obligohet KQZ që të certifikojë kandidaturën e tij për Kryetar të Komunës së Deçanit në Zgjedhjet Lokale të dt.12 Tetor 2025.


Përgjigje në ankesë ka paraqitur PZAP-i, nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet ankimore dhe propozon që ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës , vlerësoj ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të pretendimeve ankimore dhe të përgjigjes në ankesë si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pa themeltë.


Nga shkresat e lëndës rezulton se PZAP-i, më datën 22.08.2025 ka pranuar ankesën e paraqitur nga kandidati i propozuar për Kryetar të Komunës së Deçanit, në të cilën, veç tjerash, theksohet se me akt emërimin nr.050 dt.11.01.2013, është emëruar në pozitën Zyrtar i Lartë për Politika Konsullore në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me gradë koeficienti 8 dhe nivel profesional . Kjo pozitë hyn në kategorinë e shërbimit civil dhe me status të veçantë sipas Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës. Më tutje, ka theksuar se më dt.4.08.2025, ka paraqitur kërkesë për pezullim të marrëdhënies së punës, në përputhje me nenin 25 të Ligjit Nr.08/L-197, për Zyrtarët Publik. Më datën 21 gusht 2025, KQZ me vendimin nr.01/2196-2025, duke u bazuar në nenin 30 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme e ka refuzuar certifikimin e kandidatit Korab Mushkolaj, i cili është “funksionar publik dhe anëtarë i shërbimit të jashtëm” në MPJD-së. Ka theksuar se nenin 30 të LPZ, par.1, nënp.1.1 dhe 1.2 duhet të lexohen jo si ndalesë absolute, por si një kufizim i kushtëzuar dhe se KQZ, nuk ka dhënë arsyetim të plotë juridik dhe nuk kanë pas parasysh kërkesën e tij për pezullim të dt.4.08.2025.

Në anën tjetër, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka dhënë përgjigje në ankesë, përmes të cilës sqaron ecurinë e procesit të zhvilluar nga ana saj, se periudha e aplikimit për certifikim të



subjekteve politike dhe të kandidatëve të tyre ka filluar më 26 qershor 2025 dhe përfundoi më 13 gusht 2025. Ky subjekt politik ka paraqitur kandidaturë për Kuvendin e Komunës së Deçanit siç përcaktohet me Rregulloren Zgjedhore Nr.04/2024 për Certifikimin e Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre, subjekti politik ka përmbushur të gjitha obligimet përmes dorëzimit të dokumentacionit përkatës; Deklarata politike, Kodi i mirësjelljes, lista e kandidatit të subjektit politik, formulari i certifikimit të kandidatit. Lidhur me verifikimin e kandidatëve, Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, pas kompletimit të aplikimit përkatës nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, ka dërguar listën e kandidatëve për verifikim në institucionet relevante, në përputhje me nenin 30 të LZP-së, si dhe ka dërguar listën edhe te Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Nga e njëjta është verifikuar dhe ka rezultuar se Korab Mushkolaj, kandidat për Kryetar të Komunës së Deçanit, është i angazhuar me akt emërim të përhershëm në MPJD-së, si Zyrtar i Lartë në Divizionin e Ceremonialit, në Departamentin e Protokollit të Shtetit. Pas kërkesës vijuese për sqarim nga Zyra se nëse kjo pozitë llogaritet si anëtar i shërbimit të jashtëm dhe përfaqësues diplomatik, MPJD ka kthyer përgjigjen duke konfirmuar se kështu është sipas nenit 2 par.2.2 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe dispozitën e të cilit e ka cituar, si në përgjigje. Prandaj, nisur nga kjo përgjigje, Zyra ka kontaktuar, më pas, Partinë Demokratike të Kosovës, duke e udhëzuar për zëvendësimin e kandidatit, e cila ka refuzuar zëvendësimin e kandidatit sepse ai i plotëson të gjitha kriteret ligjore për të qenë kandidat. Pas gjetjes së MPJD-së, se kandidati Korab Mushkolaj hyn në kategorinë e anëtarit të shërbimit të jashtëm dhe pas refuzimit të PDK-së për zëvendësimin e tij, Zyra ka përgatitur rekomandimin për certifikimin e të gjithë kandidatëve të tjerë të PDK-së, dhe refuzimin e certifikimit për kandidatin Korab Mushkolaj, i cili më pastaj i është nënshtruar edhe votimit përkatës, me të dhënat si në shkresat e lëndës.

Në këtë gjendje të çështjes, PZAP, ka gjetur se të gjithë kandidatët tjerë të PDK-së, janë certifikuar dhe është refuzuar certifikimi për kandidatin Korab Mushkolaj, siç parashihet me par.4 të nenit 17 të LZP-së dhe nenit 2 par.2.2 të Ligjit nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, si dhe pika 1.2 par.1 i nenit 30 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe është marrë pastaj vendimi i sipër përmendur 01/2196-2025. PZAP ka vlerësuar se pretendimet e parashtruesit të ankesës përkitazi me kundërshtimin e vendimit të sipër cekur, për refuzimin e certifikimit të kandidimit të tij, janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara në ligj, sepse, pavarësisht edhe nga kërkesa për pezullim, (e cila në rastin konkret është pa ndikim në vendosje), sipas nenit 30 par.1, nënp.1.2 i LZP-së, përcaktohet se: Cilido person, emri i të cilit paraqitet në listën e votuesve, është i aftë për certifikim, si kandidat përveç nëse ai/ajo, në Republikën e Kosovës ose



jashtë saj, është: anëtar i shërbimit të jashtëm dhe përfaqësues diplomatik si dhe nenit 6 të Ligjit nr.08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, i cili parasheh se “ nëpunësi civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunësit civil, ku sipas par.1, pika 1.3, hynë edhe anëtarët e shërbimit të jashtëm”, ndaj, për arsyet e mësipërme dhe duke pasur parasysh statusin e tij të anëtarit të shërbimit të jashtëm, ky fakt, kandidaturën e tij e bënë të papërshtatshme për certifikim, andaj, në kuptim të dispozitave të nenit 117 par.3 dhe nenit 118 par.1 të LZP -së, ka vendosur si në dispozitiv të vendimit.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, i pranon si të themelta konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të PZAP-it, që ka marrë sipas vendimit të ankimuar lidhur me refuzimin e ankesës si të pa bazuar, përkitazi me mos certifikimin nga KQZ të kandidatit Korab Mushkolaj, për Kryetar të Komunës së Deçanit, me që vlerëson se vendimi i këtij organi nuk është i kundërligjshëm dhe nuk është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe as me Rregulloret a legjislationin sekondar të KQZ dhe PZAP-it.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin thëniet e parashtruesit të ankesës përkitazi me shkeljet e pretenduara, përkatësisht, mirëpo, në rastin konkret, këto pretendime u refuzuan si të pabazuara edhe nga kjo Gjykatë, sepse të njëjtat nuk janë provuar dhe faktuar, si dhe nuk kanë mbështetje ligjore, ndaj, si të tilla juridikisht, janë të paqëndrueshme. Kështu, për faktin sepse, sikundër u theksua edhe më lartë, veç tjerash, me dispozitën e nenit 30 par.1, nënp.1.2 të LZP-së, shprehimisht është përcaktuar se “ Cilido person emri i të cilit paraqitet në Listën e votuesve është i aftë për certifikim si kandidat përveç nëse ai/ajo, në Republikën e Kosovës ose jashtë saj, është: anëtar i shërbimit të jashtëm dhe përfaqësues diplomatik”, sikundër edhe është rasti konkret me statusin e kandidatit, këtu paraqitësin e ankesës Korab Mushkolaj. Kështu, në kontekstin e mësipërm, edhe me par.2 të nenit të sipër përmendur, veç tjerash, parashihet se “ Përveç ndalesave nga par.1 i këtij neni, (si më lartë) personi emri i të cilit paraqitet në Listën e votuesve nuk ka të drejtë kandidimi në zgjedhje nëse: nënp. 2.1. është dënuar në tri (3) vitet e fundit me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale....”, pastaj, nënp.2.2, nënp.2.3, etj, ku flitet shprehimisht për “ ndalesat” përkatëse siç i ka definuar ligjdhënësi, në dispozitat e sipër përmendura, nga, pra, rezulton qartë, katërçipërisht, se fjala është për “ndalesa” të specifikuara me normë ligjore.

Prandaj, nga këtu, kjo Gjykatë, konsideron se në rastin konkret juridik, është marrë vendim i drejtë, me të cilin nuk është bërë diskriminim dhe lidhur me rastin konkret nuk është



cenuar e drejta zgjedhore dhe ndonjë e drejtë themelore e paraparë me Ligj dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nuk janë shkelur parimet themelore të procesit zgjedhor të parapara shprehimisht me dispozitat e nenit 4 të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe me dispozitat përkatëse të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Nga këtu, ankuesi, me pretendimet ankimore, nuk ka arritur që të vë në dyshim vendimin e ankimuar të PZAP-it, i cili, për arsyet e sipër cekura, është i drejtë dhe i ligjshëm, andaj, kjo Gjykatë, ankesën e parashtruar nga paraqitësi i sipër përmendur, kundër vendimit të kontestuar e refuzoi si të pa themeltë.

Nga arsyet e sipër përmendura, e në pajtim me dispozitën e nenit 118 pika 4 të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

AA.nr.74/2025 dt. 27.08.2025

Kryetar i kolegjit,

Mr.Sc Muhamet Rexha



SAKTËSIA E KOPJËS E VËRTETON
ОТЧНОСТ КОПИЈА ПОТВРДУЈЕ

Funtëtori i autorizuar
D. Vlasoski



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNICA ZA-LICNO DOSTAVLANJE

Sheji i shkresës AA-764/2023
Oznaka spisa: 28.08.2023

1. Pasi marrësi, I cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dëshitë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën. apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kuëdestarit të ndërtësës fqijut, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stani radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
dana _____ u _____ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes
Razlog odbijanja prijma

Nënshkrimi i dorëzuesit - polpis dostavljaca

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebnje precrati)

Emri i shkresës që dorëzohet:

Naslov pisma koja se dostavlja:

A-Prilazak na stan
24.08.2023

Numri i shtojcave:

broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)

Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

Uroš V. L. 28/08/2023

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Polpis primioca ili lica koje je
pismeno primilo u zameni)

Nënshkrimi i dorëzuesit - polpis dostavljaca

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë
dorëzuesit, duke shkruar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet.
Ako je primilac nepletnen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostaljac.
napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.